



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 127, datë 13.2.2020

PËR

KRITERET E RREGULLAT DHE PËR LEJIMIN E VEPRIMTARISË
PËR MBLEDHJEN, AKSESIN E PËRDORIMIN E MATERIALEVE
DHE TË MOSTRAVE NGA MJEDISET E ZONAVE TË MBROJTURA
MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 65, të ligjit nr.81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e kritereve dhe të rregullave për lejimin e veprimtarisë për mbledhjen, aksesin e përdorimin e materialeve dhe të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore.
2. Mbledhja, aksesi dhe përdorimi i materialeve biologjike dhe e mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore në vegjetacione bimë, alga, myshqe dhe pjesë të tyre, në kafshë vertebrore dhe jovertebrore, në materiale mikrobike bakterie, virus dhe në kërpudha, në sasi të konsiderueshme, kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin.
3. Veprimitaria e mbledhjes dhe e përdorimit të materialeve a të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore kryhet pas miratimit të saj.
4. Të drejtën për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura e kanë institucionet kërkimore-shkencore, publike apo private, si: institucionet e arsimit të lartë, institucionet e qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit, institutet e kërkim-zhvillimit pranë

ministrive, si dhe institucionet e tjera të interesuara, organizata jofitimprurëse të specializuara të kësaj fushe, studiues, studentë, vendas apo të huaj.

5. Subjektet e parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, paraqesin kërkesën për mbledhjen e përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrotitura (në vijim, AKZM). Subjektet dorëzojnë kërkesën me shkrim pranë AKZM-Së të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të veprimtarisë së planifikuar.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) emrin e mbiemrin e aplikantit;
 - b) adresën e aplikantit;
 - c) informacionin për veprimtarinë e kryer nga subjekti që ka paraqitur kërkesën;
 - ç) listën e anëtarëve të stafit që do marrin pjesë në veprimtarinë e aksesit, të mbledhjes e të përdorimit të materialeve biologjike ose të mostrave;
 - d) fushën e veprimtarisë dhe qëllimin e aksesit, të mbledhjes e të përdorimit të materialeve biologjike ose të mostrave;
 - dh) materialin biologjik që do të jetë objekt i veprimtarisë së aksesit, mbledhjes dhe të përdorimit, numrin e mostrave dhe sasitë përkatëse (që duhet të janë në masën më minimale të nevojshme);
 - e) vendin dhe kohën e kryerjes së veprimtarisë;
 - ë) kushtet e ruajtjes e të transportit të materialeve biologjike ose të mostrave; dhe
 - f) deklaratën se veprimtaria nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të erozionit gjenetik/humbjes.
6. Kërkesa me shkrim shoqërohet me informacionin e nevojshëm, sipas shtojcave 1, 2 e 3, dhe formularin e vetëdeklarimit, sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 7. AKZM-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur në bazë të kritereve të mëposhtme:
 - a) Veprimtaria kërkimore të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e mbrojtjen e natyrës dhe të planeve të menaxhimit;
 - b) Metodika e kampionimit të mos ndikojë në konservimin dhe në biologjinë e llojit;
 - c) Veprimtaria kërkimore të mos ketë ndikim negativ në diversitetin biologjik;
 - ç) Të jetë marrë miratimi paraprak për aksesin e përdorimin e materialit biologjik ndërmjet pronarit, kur toka është pronë private, dhe

- subjekteve/individëve, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi;
- d) Të jetë rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, në Republikën e Shqipërisë.
8. Kur kërkesa për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve a të mostrave biologjike nga mjediset e zonave të mbrojtura paraqitet nga organizata joftimprurëse e specializuar e kësaj fushe, studiues, studentë, vendas apo të huaj, veprimtaria përmban edhe këto kushte:
- Ndarjen ose përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore ndërmjet studiuesve, vendas e të huaj, duke u mbështetur në kushtet e vendosura paraprakisht në marrëveshje dhe në bazë të rezultateve përfundimtare;
 - Të drejtën që Republika e Shqipërisë t'i shfrytëzojë a t'i përdorë kampionet ose produktin e arritur, si dhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre veprimtarive;
 - Vlerësimin e të dhënavëve për zyrtarizimin e tyre;
 - Pëlqimin e dhënë nga ministri, që të dhënat e rezultateve të kërkimeve të pasqyrohen në rrjetet ndërkombëtare të informacionit.
9. Në rast se AKZM-ja konstaton se kërkesa e paraqitur nga subjektet kërkuese të parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, nuk plotëson kushtet/kriteret e përcaktuara në këtë vendim, Agjencia njofton subjektet për të bërë plotësimet e nevojshme brenda një afati 10- (dhjetë-) ditor.
10. AKZM-ja, pas plotësimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën brenda afatit të parashikuar në pikën 7, të këtij vendimi, dhe, në përputhje me kushtet/kriteret e këtij vendimi, brenda 7 (shtatë) ditëve, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit për veprimtarinë.
11. Materialet e mbledhura si pjesë e veprimtarive kërkimore mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose e pronarit nga i cili janë mbledhur fillimisht dhe kthehen me përfundimin e veprimtarisë kërkimore, nëse nuk është rënë dakord ndryshtë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.
12. Personeli i zonës së mbrojtur mjedisore, për të gjitha rastet e kryerjes së veprimtarisë së mbledhjes së materialeve dhe të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore, shoqëron subjektet fizike e juridike, vendas e të huaj, gjatë kryerjes së veprimtarisë prej tyre. Në rastet kur këto subjekte nuk njoftojnë Administratën e Zonave të Mbrojtura (në vijim, AdZM), ato nuk lejohen të kryejnë veprimtarinë dhe AdZM-ja njofton AKZM-në për marrjen e masave të nevojshme, deri në propozimin për shfuqizimin e miratimit të veprimtarisë.

13. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I
EDI RAMA

MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
BLENDI KLOSI



Shtojca nr.1

**DETAJE TË PËRGJITHSHME PËR APLIKIMIN
PËR TË DREJTËN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE**

PËR

**MIRATIMIN E VEPRIMTARISË PËR MBLEDHJEN, AKSESIN E PËRDORIMIN E
MATERIALEVE DHE TË MOSTRAVE NGA MJEDISET E ZONAVE
TË MBROJTURA MJEDISORE**

Ky formular do të përdoret për mbledhjen dhe përdorimin e materialeve biologjike dhe mostrave, të cilat do të kryhen brenda zonave të mbrojtura

1.1 Emër Mbiemër:			
1.2 Institucioni:			
1.2.1 Titulli:			
1.3 Adresa:			
1.3.1 Kodi postar:			
1.4 Nr. i telefonit/		e-mail:	NUIS

1.5. Titulli i studimit/projektit:

1.6. Koordinatat gjeografike të zonës:

1.7 Përshkrimi i shkurtër i projektit:

**1.8 Qëllimin e aksesit, i mbledhjes dhe i përdorimit të materialeve
biologjike ose mostrave:**

1.9 Metodologjia e studimit/projektit:

1.2.0 Fillimi dhe mbarimi i projektit:

Shtojea nr.2

DETAJE PËR VEPRIMTARINË

2.1 Emri i zonës së mbrojtur:

2.2 Qarku:

2.3 Emri latinisht i llojit:

Vegjetacion

Bimë

Alga

Myshk

**Pjesë të
tyre**

Kafshë

Vertebrorë

Jovertebrorë

Mikrobik:

Bakterie

Virus

Kërpudha

2.4 Emri i zakonshëm i llojit

Statusi i llojit

I rrezikuar

I përkeqësuar

I kërcënuar

Sasia

Shpeshtësia

Shtojca nr.3

3.1 Transferimi i materialit nga burimet *in situ* në *ex situ*

- | | |
|-----------------------------------------------|--------------------------|
| Banka gjenetike | <input type="checkbox"/> |
| Kopshte/parqe zoologjike | <input type="checkbox"/> |
| Kopshte botanike | <input type="checkbox"/> |
| Akuarium | <input type="checkbox"/> |
| Laboratorë të specializuar të bioteknologjisë | <input type="checkbox"/> |

Shtoja nr.4

V E T Ë D E K L A R I M

Unë i/e nënshkruari _____, i datëlindjes _____
(emër atësi mbiemër) (datë/muaj/vit)

Nëse aplikanti përfaqëson një institucion, duhet të saktësojë pozicionin që mban

deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se mbaj përgjegjësi personale për të gjithë informacionin që është plotësuar në këtë formular dhe se veprimtaria e kërkimit shkencor nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të prishjes së ekuilibrave natyrorë dhe se, mbas përfundimit të projektit, do të dorëzoj pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.

Deklaruesi

Datë

Firma

NR.PROT. 1055/1
DATË 14-2- 2020

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË
MBROJTURA
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

